



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,

th ë r r e t

mbledhjen e **tretë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **22.04.2022** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2021 në vitin 2022;
3. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2022 (TM1);
4. Raporti i punës i Komunës së Prishtinës (7 dhjetor 2021 - 31 mars 2022);
5. Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
6. Propozimvendimi për subvencionimin e shoqatave të dala nga lufta;
7. Propozimvendimi për shfuqizimin e pjesërishëm të Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-0088887/20, i dt. 11.06.2020;
8. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomëve në Prishtinë;
9. Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe volejbollit në Prishtinë;
10. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktiviteteve "3x3 Prishtina Fiba Challenger";

11. Propozimvendimi për subvencionimin e nënave lehona, përfituese të skemës sociale (për të posalindurit e tyre);
12. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete, të datës 11.02.2022;
13. Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës, për inicimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në ndërmarrjen publike lokale;
14. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;
15. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Platformës Multifunksionale, Teatrit të Operas dhe Baletit në Prishtinë;
16. Shqyrtimi i përgjigjes nga MAPL, lidhur me Vendimin për caktimin e lokacionit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve;
17. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-060/01-80960/22, më 13.04.2022

KRYESUESI I KOMITETIT
Fehmi Kupina

